



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 10 datë 27.02.2015

**Për**

**“TRANSFERIMIN KAPITAL TË MJETIT TË TRANSPORTIT DHE TË  
PAISJEVE TË INVENTARIT EKONOMIK DHE PAISJEVE TEKNIKE NGA  
APARATI I BASHKISË SË TIRANËS NË NJËSITË SHPENZUESE QË I KANË  
NË PËRDORIM”**

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 për “Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (i ndryshuar); pikën 2, shkronja “ç” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 03.04.1993 për “Kalimin kapital të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” (i ndryshuar); udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me propozimin e kryetarit të bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të bëhet kalimi kapital nga aparati i Bashkisë së Tiranës në inventarin e Qendrës Sociale “Të qëndrojmë sëbashku”, i mjetit të transportit furgon transportier (8+1) Wolkswagen me targë TR 9475 R me vlerë bruto 2.940 000 lekë, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur.
2. Të bëhet kalimi kapital nga aparati i Bashkisë së Tiranës në inventarin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit i artikujve të inventarit ekonomik dhe paisjeve teknike në përdorim, në vlerën bruto 2.231.534 lekë sipas tabelës nr.2.1 dhe 2.2 bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku” për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**ALDRIN DALIPI**